

VIKTIMIZIMI NGA NGACMIMET SEKSUALE DHE FAJËSIMI I VIKTIMËS
SI PARASHIKUES TË FUNKSIONIMIT PSIKOLOGJIK NEGATIV TEK
STUDENTET FEMRA

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE
KËSHILLIM

nga

AURELA BERISHA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK

Prishtinë

Shtator, 2023

Viktimizimi nga Ngacmimet Seksuale dhe Fajësimi i Viktimës si Parashikues të Funksionimit Psikologjik Negativ tek Studentet Femra

Aurela Berisha

Mentor: Prof. Dr. Aliriza Arënliu

Ngacmimi seksual është një çështje me shqetësim të madh për shëndetin publik, që prek individët në demografi të ndryshme, ku studentët femra janë veçanërisht të cenueshme. Kjo ekspozitë prezanton një tezë masteri, studimi i të cilit pritet të japë një kontribut të rëndësishëm në fushën e kërkimit të ngacmimeve seksuale duke sqaruar marrëdhëniet e ndërlikuara midis viktimizimit nga ngacmimet seksuale, fajësimin e viktimave dhe funksionimin negativ psikologjik të studentet femra. Duke i kuptuar më mirë këto dinamika, ne mund të sugjerojmë strategjitë e parandalimit dhe ndërhyrjes për të mbështetur viktimat dhe për të sfiduar qëndrimet e fajësimin të viktimave. Në këtë studim, ngacmimi seksual përkufizohet si çdo lloj abuzimi, sulmi, ngacmimi, shfrytëzimi dhe/ose frikësimi i drejtpërdrejtë ose indirekt me bazë seksuale, pavarësisht nëse është kryer në të tashmen ose në të kaluarën nga të huaj, individë në pozita autoriteti, partnerë romantikë ose anëtarët e familjes.

Funksionimi psikologjik u konceptua si në aspektin e mungesës/prezencës së psikopatologjisë ashtu edhe të mirëqenies psikologjike (Banks & Salmon, 2013). Përvoja nga ngacmimet seksuale në popullatat e rritura, duke përfshirë popullatat e studentëve të universiteteve ka qenë vazhdimisht e lidhur me një gamë të gjerë indeksesh psikologjike të funksionimit negativ (Fedina et al., 2016; Klump, 2006; Turchik & Hassija, 2014). Sikur të mos ishte mjaftueshem përballja me këto përjetime traumatike që sjell vet ngacmimi seksual, një problem tjetër që ndikon në shëndetin mendor të viktimave të ngacmimeve seksuale është kultura e 'fajësimin të viktimës'; viktimat e ngacmimeve seksuale që flasin hapur për përvojat e tyre shpesh paragjykojnë dhe u nënshtrojnë reagimeve negative nga shoqëria. Këto reagime negative mund të shkaktojnë në këtë mënyrë një funksion heshtës, duke bërë që disa viktimat të ndalojnë së foluri për përvojat e tyre me këdo (Campbell & Raja, 1999). Sipas përkufizimit fajësimi i viktimës është kur dikush trajton një viktimë të sjelljes së dëmshme ose abuzive sikur

trajtimi i tyre të jetë shkaktuar nga diçka që ai ka thënë ose ka bërë, në vend që ta hedhë fajin aty ku i takon; mbi kryesin e veprës (Mansour et al., 2021).

Kosova përballlet me sfida të ndryshme në adresimin e ngacmimeve seksuale, duke përfshirë nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit, përmirësimin e mekanizmave të raportimit, koordinimin më të mirë ndërmjet institucioneve dhe qasjen në shërbimet mbështetëse. Në Kosovë, ngacmimi seksual është i përhapur edhe pse raportimi i rasteve të ngacmimit seksual duket që pothuajse nuk ekziston, në rastet kur janë bërë raporte, shumica e raporteve mbeten të patrajtuara. Shumica e përfaqësuesve të institucioneve shpesh nuk kanë ndërgjegjësim për ngacmimin seksual, përkufizimin e tij, kuadrin ligjor përkatës, si dhe mënyrat më të mira për ta trajtuar atë. Ata shpesh ngatërrojnë ngacmimin seksual me përdhunim ose sulm seksual, ndërsa llojet "më pak serioze" ose janë të padëgjues ose konsiderohen si të parëndësishme. Po ashtu, kultura e "fajësimit të viktimës" në rastet kur ndodhë ngacmimi është prevalente; rreth 74% e kosovarëve besojnë se gratë vetë e sjellin punën deri te ngacmimi në bazë të asaj se si vishen ose se si sillen (Artpolis, 2020, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2016).

Kështu, qëllimi i këtij studimi është të analizojë prevalencën e formave të ndryshme të ngacmimeve seksuale tek studentët femra dhe rrjedhëmisht të ekzaminojë lidhshmërinë ndërmjet viktimizimit nga ngacmimet seksuale dhe fajësimit të viktimës si parashikues të funksionimit psikologjik negativ tek studentet femra. Përkatësisht, ky studim tenton t'u përgjigjet këtyre pyetjeve kërkimore: (a) Cila është ndërlidhja ndërmjet viktimizimit nga ngacmimet seksuale dhe funksionimit psikologjik tek studentet femra? (b) Cila është ndërlidhja ndërmjet fajësimit të viktimave të ngacmimve seksuale dhe funksionimit psikologjik tek studentet femra? (c) Cila është ndërlidhja ndërmjet viktimizimit nga ngacmimet seksuale dhe fajësimit të viktimave tek funksionimi psikologjik i studenteve femra? (d) A janë studentet apo jo studentet femra më rrezik për viktimizim të ngacmimeve seksuale?

Në këtë mënyrë do të tentohen të eksploroohen dhe vertetohen apo jo çështjet që kanë të bëjnë me këto hipoteza;

(H1) Ekziston një ndërlidhje pozitive ndërmjet viktimizimit nga ngacmimet seksuale dhe funksionimit psikologjik tek studentet femra

(H2) Ekziston një ndërlidhje pozitive ndërmjet fajësimit të viktimës të ngacmimeve seksuale dhe të funksionimit psikologjik tek studentet femra

(H3) Ekziston një ndërlidhje pozitive ndërmjet viktimizimit nga ngacmimet seksuale dhe fajësimin të viktimës tek funksionimi psikologjik i studenteve femra

(H4) Femrat që vijojnë studimet në universitet janë më rrezik për viktimizim nga ngacmimet seksuale se sa femrat që nuk vijojnë studime në universitet.

Ky studim përdor teorinë ekologjike të Bronfenbrennerit (1979, 1986, 1995) për të ekzaminuar në mënyrë gjithëpërfshirëse se si viktimizimi nga ngacmimet seksuale dhe fajësimi i viktimave mund të ndikojnë në funksionimin psikologjik të studentëve femra. Duke marrë parasysh shtresat e shumta ekologjike dhe ndërveprimin e tyre, kjo teori ofron një kuptim gjithëpërfshirës të faktorëve që ndikojnë në mirëqenien psikologjike të këtyre viktimave dhe si rrjedhojë duke kontribuar në zhvillimin e sistemeve, politikave dhe ndërhyrjeve më efektive mbështetëse për të adresuar këtë çështje.

Dizajni hulumtues që është përdorur është ai korrelacional hulumtues. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur metoda kuantitative më saktë teknika e vetëraportimit përmes pyetësorëve. Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet një sondazhi online. Pjesëmarrësit të cilët morën pjesë në mënyrë vullnetare në këtë hulumtim ishin gjithsej N=204 studente femra, që përfshin 47,1% studentë dhe 52.9% jo studente, duke filluar nga mosha 18 vjeçare. Mostrimi që është përdorur është i konviniencës ku pjesëmarrësit kanë zgjedhur vetë nëse dëshirojnë të marrin pjesë. Mostrat e konviniencës përdoren më shumë për popullata që janë të vështira për t'u gjetur, anëtarët e të cilëve mund të ngurrojnë të identifikohen (Raifman et al., 2022). Studimi përdori një pyetësor të përbërë nga katër seksione; një që fokusohet në viktimizimin nga ngacmimet seksuale, një tjetër në fajësimin e viktimës dhe dy trajtojnë funksionimin psikologjik, duke përfshirë vlerësimet e depresionit, stresit, ankthit dhe njohjeve post-traumatike. Pjesëmarrësit përveç që janë informuar për qëllimin e hulumtimit, rëndësinë e tij, ata gjithashtu janë njoftuar edhe me çështjet e konfidencialitetit, anonimitetit, dhe faktit që ato të dhëna do përdoren vetëm për qëllime hulumtuese.

Në këtë studim, 75 femra janë deklaruar që kanë përjetuar të paktën një ngacmim seksual (N=204). Për sa i përket se ku kishe ndodhur ngacmimi, 82.7% të ngacmimeve kishin ndodhur jashtë ambienteve të universitetit, dhe 10.7% brenda universitetit, ndërsa 6.7% prej tyre brenda dhe jashtë universitetit. Gjithashtu, 75.7% të viktimave i kanë treguar miqve ose anëtarve të familjes për incidentin, ndërsa 22.6% të viktimave i kanë treguar institucioneve tjera përkatëse.

Nga rezultatet gjetëm prova të forta që mbështesin hipotezen e parë, duke treguar se ka vërtet një ndërlidhje signifikante pozitive ndërmjet përjetimit të ngacmimit seksual dhe funksionimit psikologjik të studenteve femra. Ky zbulim nxjerr në pah ndikimin e dëmshëm që ngacmimi seksual mund të ketë në funksionimin psikologjik të studenteve femra dhe po ashtu mbështetet nga studime të shumta që vazhdimisht kanë dokumentuar ndikimin e thellë psikologjik të ngacmimit seksual mbi viktimat. Po ashtu, edhe tek ndërlidhja ndërmjet fajësimit të viktimës nga ngacmimet seksuale dhe funksionimit psikologjik të tyre është gjetur një ndërlidhje mjaft signifikante. Mbështetja e hipotezës së dytë nxjerr në pah rolin e dëmshëm të fajësimit të viktimës në përkeqësimin e mëtejshëm të sfidave psikologjike me të cilat përballen viktimat. Pra, studentet femra që përballen me ngacmime seksuale fillimisht traumatizohen nga vetë akti. Nëse këto studente më pas përjetojnë fajësimin e viktimës, ata pësojnë një traumë dytësore, që mund të marrin nga bashkëmoshatarët, autoritetet ose shoqëria në përgjithësi dhe mund të intensifikojë pasojat psikologjike. Hipoteza e tretë sugjeron një efekt ndërveprues, duke treguar se studentet femra që përjetojnë ngacmime seksuale dhe më pas ndeshen me qëndrime fajësuese janë në një rrezik të përforcuar të rezultateve të pafavorshme psikologjike. Studimi gjen ndërlidhje signifikante mes viktimave të ngacmimeve seksuale që gjithashtu kanë përjetuar fajësim, dhe atyre që nuk kanë përjetuar fajësim.

Për sa i përket hipotezës së katërt, që studentet femra janë më në rrezik për t'u viktimizuar nga ngacmimet seksuale se sa jo studentet femra, nuk është gjetur ndonjë diferencë signifikante. Ky zbulim thekson se rreziku i ngacmimit seksual është një çështje më e gjerë shoqërore dhe nuk kufizohet në mjediset akademike, pra, bazuar në të dhënat e mbledhura dhe parametrat e këtij studimi specifik, të qenit studente nuk e vendos domosdoshmërisht në një rrezik më të lartë për ngacmim seksual në krahasim me jo studentet. Pra, gjetjet e këtij studimi tregojnë një ndërlidhje signifikante pozitive ndërmjet viktimizimit nga ngacmimet seksuale dhe fajësimit të viktimës mbi funksionimin psikologjik të studentëve femra, të cilat janë në përputhje me literaturën ekzistuese. Gjetje të tilla theksojnë traumën komplekse dhe të shtresuar të përjetuar nga viktimat dhe pasojat e thella psikologjike të ngacmimit dhe fajësimit të mëvonshëm të viktimës. Duke pasur parasysh këtë shtrirje, ky studim jo vetëm që përforcon njohuritë ekzistuese, por gjithashtu ofron dëshmi bashkëkohore mbi rëndësinë e vazhdueshme të temës, nënvizon nevojën urgjente për masa parandaluese, sisteme mbështetëse dhe ndërhyrje arsimore

për të trajtuar si ngacmimin ashtu edhe kulturën e fajësimit të viktimave, veçanërisht brenda mjediseve universitare.

Ky studim hedh dritë mbi implikimet e thella psikologjike nga ngacmimet seksuale dhe efektet e ndërlikuara të fajësimit të viktimave tek studentet femra, thekson rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit për ngacmimet seksuale dhe qëndrimet e fajësimit të viktimave. Ai thekson nevojën për programe arsimore në kampuset e universitetit që jo vetëm trajtojnë parandalimin e ngacmimeve seksuale, por gjithashtu sfidojnë besimet e fajësimit të viktimave. Një implikim praktik i menjëhershëm i studimit është nevoja që universitetet të përmirësojnë shërbimet e tyre të mbështetjes së shëndetit mendor për studentet femra që kanë përjetuar ngacmime seksuale, kjo mund të përfshijë ofrimin e këshillimit dhe terapisë së specializuar, krijimin e hapësirave të sigurta dhe konfidenciale për viktimat që të kërkojnë ndihmë dhe rritjen e ndërgjegjësimit midis studentëve dhe stafit për burimet në dispozicion. Megjithatë, ai gjithashtu nënvizon nocionin se sfida të tilla nuk kufizohen në mjediset arsimore. Kjo mund të kontribuojë në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më empatik brenda dhe jashtë institucioneve.

Kur merret parasysh metodologjia e përdorur, gjetjet, megjithëse të rëndësishme, duhet të interpretohen me kujdes për shkak të paragjyqimeve të mundshme dhe specifikave të grupit të mostrës. Si rrjedhojë, ky studim tregon nevojën për kërkime të vazhdueshme në këtë fushë. Një temë komplekse dhe e ndjeshme si i këtij studimi kërkon nevojën për një dizajn kërkimor me metoda të përziera i cili do të ofronte një eksplorim më të thellë dhe më të nuancuar. Ai lejon një qasje holistike që kombinon ashpërsinë statistikore të kërkimit kuantitativ me pasurinë e të dhënave kualitative, duke kontribuar përfundimisht në një kuptim më të thellë dhe më kuptimplotë të temës. Ndërsa këto gjetje kontribuojnë me njohuri të vlefshme në këtë fushë duke paraqitur një kuptim më të larmishëm të fenomenit, është thelbësore të pranohet se përvojat individuale dhe kolektive mund të ndryshojnë për shkak të variablave të shumta, dhe ajo që është e vërtetë në një kontekst ose mostër mund të mos zbatohet domosdoshmërisht në mënyrë universale. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e kërkimit të vazhdueshëm për të kapur spektrin e gjerë të përvojave dhe rezultateve të lidhura me viktimizimin nga ngacmimet seksuale dhe fajësimin e viktimave në funksionimin psikologjik.